



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

THIRRJE PËR APLIKIM

Përkrahje me Mekanizëm Bujqësor
(Subvencione në kuadër të sektorëve: Lavërtari, Perimtari, Pemëtari,
Vreshtari)

Gjakovë, Qershor 2024

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 10 dhe 14 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës me Nr. 01/110-01-3560 të datës 04.02.2020, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) :

Njofton fermerët e Komunës së Gjakovës, që mund të aplikojnë për skemën e subvencioneve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbështetjen e tyre me pajisje (mekanizëm bujqësor):

- **Spërkatëse dhe Shpërndarëse Plehu**
- **Freza 1.8m,**
- **Pllug 3 Brazd Statik,**
- **Motokultivator 4.4 KW,**
- **Motokultivator 9.0 KW.**

Kriteret :

- Ndarja proporcionale sipas rajoneve – pesë (5) rajone;
- Fermeret femra, minoritetet dhe të rinjët kanë përparësi;
- Përfituesit duhet të bashkë financojnë vlerën e pajisjes minimum 20%;
- Aplikuesit të mos jenë përfitues të Subvencioneve nga Komuna nga viti paraprak dhe viti aktual;
- Përfituesi duhet të jetë banor i Komunës së Gjakovës;
- Fermeri ka të drejte të aplikojë vetëm për një pajisje;
- Te jete aplikues ne Pagesa Direkte ne kuadër të MBPZHR-se (për vitin 2024);
- Aplikuesit për Spërkatëse dhe Shpërndarëse të plehut duhet të kenë në pronësi (ose me qera) së paku 3.00 ha tokë të punueshme të aplikuar ne Pagesa Direkte.
- Aplikuesit per Pllug duhet të kenë në pronësi (ose me qera) së paku 3.00 ha tokë të punueshme të aplikuar ne Pagesa Direkte.
- Aplikuesit per Freza duhet të kenë në pronësi (ose me qera) së paku 1.00 ha tokë të punueshme të aplikuar ne Pagesa Direkte.
- Aplikuesit per Motokultivator 4.4KW duhet të kenë në pronësi (ose me qera) së paku 0.30 ha toke të kultivuar me perimkulture, së paku 0.10 ha toke të kultivuar me Vreshta ose së paku 0.50 ha toke të kultivuar me pemë e aplikuar ne Pagesa Direkte;
- Aplikuesit për Motokultivator 9.0 KW duhet të kenë në pronësi (ose me qera) së paku 1.00 ha toke të kultivuar me perime, së paku 2.00 ha toke të kultivuar me peme dhe se paku 5.00 të mbjella me kultura lavërtarë aplikuar ne Pagesa Direkte.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Numri identifikues i fermerit (NIF - kopje);
- Vërtetimi i tatimit në pronë;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme - Lista poseduese (kopje);

Fletë aplikacioni tërhiqet në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) të Komunës së Gjakovës.

Afati i aplikimit: **19.06.2024 deri me 03.07.2024**